



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1415/9 Prot.

Tiranë, më 29.12.2022

V E N D I M

Nr. 235, Datë 29.12.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 202, datë 20.12.2022¹, e shtetasit J.S, pa përcaktuar subjektin kundër të cilit ankohet dhe pa përcaktuar shkakun e diskriminimit.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: *“Ditari im 50-vjeçar e lë në dispozicion, aty ka të gjithë diskriminimin tim. Në komunizëm dhe tani në demokraci keni ndërruar vetëm kostumin. Janë fuqizuar me kompiutera me vrasje e shumë kriminalitete kudo dhe thonë largohu në drejtim të paditur. Kam nevojë të madhe për një komision të që shohi bodrumin ku kam thesarin e A.K”*.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pajisjen me një studio për të ekzpozuar punimet artistike.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje*

¹ KMD me shkresat nr. 1415/1, datë 03.11.2022 dhe nr. 1415/3, datë 23.11.2022, ka kërkuar nga J.S shpjegimin e situatës dhe shkakun e diskriminimit.

me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Subjekti ankues është shprehur se i është drejtuar shumë institucioneve, për të shprehur kërkesën për tu pajisur me një studio për ruajtjen dhe ekspozimin e shumë punimeve artistike të tij, por nuk ka marrë përgjigje.

Në ankesën e bërë pranë Komisionerit, J.S nuk ka paraqitur asnjë shkresë/kërkesë që i ka drejtuar institucioneve. Gjithashtu, ankuesi nuk ka dhënë asnjë shpjegim lidhur me situatën diskriminuese dhe shkakun e pretenduar për diskriminim.

Në kushtet kur, nuk provohet se ankuesi i është drejtuar institucioneve, Komisioneri vlerëson se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim të mtejshëm lidhur me ankesën e J.S.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;.....”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të

mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj².

Komisioneri i rekomandon subjektit ankues, që t'i drejtohet institucioneve përgjegjëse me kërkesë zyrtare në lidhje me atë që ai pretendon. Në vijim, nëse kërkesa e tij nuk do të pranohet, ankuesi mund t'i drejtohet përsëri Komisionerit, nëse do të pretendojë se shkaqet e refuzimit përbëjnë diskriminim.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga J.S, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

² Për analogji citojmë Vendimin nr. 114, datë 10.06.2022.